



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 586 Prot.

Tiranë, më datë 21.11.2024

VENDIM
Nr. 498, datë 21.11.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, V.K.M. Nr. 792, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, i ndyshuar, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.11.2024:

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e kërkesës së **Znj. Fatjona Angjellari** për paisje me Licencë individuale në Projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë P/A/1, P/A/2, P/A/3, P/A/4, P/A/5, P/A/6, P/A/7, pasi nuk plotëson numrin e projekteve në këto nënkategori;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

